



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
“SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME” DIBËR SH.A

---

Datë 19.04.2024

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**Objekti i procedurës:** “Studim Projektim Ndertimi I rrjetit të kanalizimeve të ujrave te ndotura dhe impianti I pastrimit te qytetit Peshkopi, ne Bashkine Dibër”

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):** 22114311-5 - Projekte, 79415200-8 - Shërbime të konsulencës në projektim

**Vlera e fondit limit:** 26,836,920 (njëzet e gjashtë milion e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e njëzet) Lekë pa TVSH

**Burimi i Financimit:** Vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, sipas Shkresës të Agjencisë Kombëtare Ujësjellës-Kanalizime me Nr. 948 Prot, të datës 20.03.2024, protokolluar me tonën Nr.359 Prot., datë 25.03.2024, Lënda “Dërgohet detajimi i buxhetit 2024-2026 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj për programin furnizim me ujë dhe kanalizime”, miratuar “Studim Projektim Ndertimi I rrjetit të kanalizimeve të ujrave te ndotura dhe impianti I pastrimit te qytetit Peshkopi, ne Bashkine Dibër ”, 6,440,861 lekë me tvsh, Buxheti për 2025: 25,736,443 lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Agjencia Kombëtare e Ujësjellës - Kanalizimeve, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

## 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

c. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “a” formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat ligjore sipas pikës 1 të Shtojcës 11 të DST.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, (i ndryshuar).

*Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

- b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga autoriteti përgjegjës për xhiron vjetore të realizuar në tre vitet e fundit ushtrimore 2021, 2022, 2023, vlera mesatare e të cilës duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e fondit limit pa TVSH.
- c) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.*

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar sipas vlerës së fondit limit të kësaj procedure, sipas nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, si dhe neneve 43 dhe 47, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim që autoriteti kontraktor të kuptojë nëse operatorët ekonomikë ofertues kanë apo zotërojnë mundësitë e nevojshme financiare për të përbyllur punët publike me sukses. Xhirot e tre viteve të fundit janë 2020, 2021 dhe 2022, që rezulton të jenë përmbullur edhe sipas legjislacionit tatimor. Përqindja e kërkuar mbi xhiron vjetore është një përqindje minimale sipas RRPP-ve dhe xhiro e tre vjetëve e kërkuar, jo vetëm që përputhet me praktikën administrative të prokurimeve publike të ndjekur deri më tani, por është e rëndësishme për të vlerësuar kapacitetin ekonomik të ofertuesit dhe kuptuar nëse është i aftë financiarisht për të përbyllur punët publike pranë autoritetit kontraktor.*

*Po kështu, që nga operatorët ekonomikë të vërtetohet kapaciteti ekonomik, ata mund të paraqesin kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2020, 2021, 2022, si mbas xhirove vjetore, të depozituar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar. Paraqitja e bilanceve është një mundësi, në rast se operatori ekonomik ofertues paraqet xhirot e kërkuara. Këto kërkesa të vendosura në DST (për mundësinë e paraqitjes së bilanceve dhe detyrimin e paraqitjes së dokumenteve për xhiron vjetore) përputhen edhe me nenin 9 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, sipas të cilëve periudha e raportimit financiar është 12 muaj dhe periudha e depozitimit të pasqyrave financiare është nga 12-15 muaj.*

*Gjithashtu, për të vërtetuar kapacitetin ekonomik, operatori ekonomik ofertues duhet të depozitojë vërtetim që konfirmon shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti lokal për tre vitet e fundit, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku ai ushtron aktivitetin sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së/QKB-së. Kjo kërkesë buron nga neni 76 i LPP-së, ligji nr. 139/2015 “Për*

*vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, sipas të cilëve subjektet tregtare kanë detyrimin që të paguajnë taksat vendore, me qëllim që të ushtrojnë aktivitetin. Vitet përkojnë me 2020, 2021 dhe 2022. Të gjitha kërkesat lidhur me kapacitetin ekonomik janë të bazuara në legjislacionin e përmendur më sipër dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse ofertuesit kanë kapacitete për të nisur dhe përfunduar punët publike që prokurohen. Po kështu, duke qenë se mund*

*të marrin pjesë si ofertues edhe bashkime operatorësh ekonomikë, atëherë secili prej operatorëve ekonomikë të bashkuar, duhet të depozitojë dokumentacionin si më lart.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”; si dhe shkronjës c, të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku parashikohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”. Po kështu, kjo kërkesë bazohet edhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme në punët e realizuara, sipas nenit 41 të rregullave të prokurimit publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së përllorarit të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më pak se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; Situacion Përfundimtar dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në vlerën limit të kontratës për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Këto vlera janë vlerat minimale të kërkuara sipas RRPP-ve.*

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; Situacion Përfundimtar dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor.*

b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme pranë subjekteve private, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. Dokumentet e mësipërme janë të mbështetura edhe në legjislacionin në fuqi të zbatueshëm për ndërtimet.*

*Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. Kjo kërkesë bazohet në nenet 88 e në vijim të LPP,*

### 2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- **3.a** Projektim objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate
- **4.c** Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- **5.c** Projektim ujësjellës kanalizime urbane – rurale.
- **8.a** Rivelime inxhinierike.
- **8.d** Bazamente gjeodezike
- **9.d** Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet
- **14** Studime e projektme te ndertimit te impianteve te trajtimit te ujrave te zeza

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. **Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.** (Për Operatorët e huaj të bëhet njësimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Sipas këtij kriteri, operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

<b>KATEGORIA E KËRKUAR</b>	<b>PËRSHKRIMI I KATEGORISË</b>	<b>ARGUMENTIMI</b>
<b>3.a</b>	Projektim objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate	Bazuar në shërbimet e kerkuara në Detyrën e Projektimit, parashikohet kryerja e shërbimeve te lidhura kryesisht me projektimin e strukturave beton-arme me/pa prani të ujit, vlerësimi i ngarkesave në tubacionet, pusetave apo dhoma kontrolli, kalimet e rrugëve kryesore dhe rrjeteve inxhinierike dhe si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>4.c</b>	Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale	Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, parashikohet projektimi për impiantet elektrike, mekanike, stacionet e pompimit, makinerive, paisjeve por jo vetëm të kufizuar në to; përgatitja e preventivit dhe analizat e kostos për pajisje elektromekanike, hartimin e relacionit teknik për elektromekanike dhe specifikimeve teknike elektro-mekanike dhe si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>5.c</b>	Projektim ujësjellës kanalizime urbane – rurale.	Bazuar në shërbimet e kerkuara në Detyrën e Projektimit, parashikohet mbulimi i plotë me rrjet kanalizimesh për të gjithë zonën e studimit duke plotësuar nevojat higjienike dhe mjedisore të zones së studimit dhe lokaliteteve me rëndësi turistike, realizimi i projektit te detajuar teknik perfshire preventivin e punimeve per ndertimin e rrjetit të kanalizimit , si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>8.a</b>	Rilevime inxhinierike.	Bazuar në shërbimet e kerkuara në Detyrën e Projektimit, parashikohet te kryhet azhornimi i rrugeve dhe te gjithe hapesires ku mendohet te kaloje sistemi i kanalizimit, te jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak ne terren per sakesine e te dhenave, perpara fillimit te projektit te zbatimit. Investigim i pozicioneve të mundshme për një ITUN të ri, duke përfshirë rishikimin e disponueshmërisë së trupit të duhur uJOR pritës për shkarkimin e ujërave të ndotura të trajtuara, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>8.d</b>	Bazamente gjeodezike	Bazuar në shërbimet e kerkuara në Detyrën e Projektimit, parashikohet identifikimi dhe shënimi i pikave për pozicionim dhe rilevim, hartimi i përshkrimeve për pikat e palëvizshme dhe shoqëruar me skemat përkatëse, kryerja e matjeve për të përcaktuar pikat fikse dhe ato të kontrollit, si dhe analizimi i matjeve dhe hartimi i rrjetit mbështetës gjeodezik dhe

		atë të rilevimit, rrjedhimisht gjykohet e nevojshme kjo pike për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>9.d</b>	Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet	Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, parashikohet se projektuesi duhet të bëjë studimet e nevojshme gjeologjike të trojeve dhe shpateve me qendrueshmeri të ulet për ndërtimin e objektit inxhinierik përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>14</b>	Studime e projektme te ndertimit te impianteve te trajtimit te ujrave te zeza	Bazuar në shërbimet e kërkuara në Detyrën e Projektimit, duke qenë se parashikohet ndërtimi i Impianit të Trajtimit të Ujrave të Ndotura dhe si e tillë një pjesë e konsiderueshme e shërbimit i dedikohet trajtimit të ujrave të ndotura si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

**2.3.3.Operatori ekonomik duhet të ketë Drejtuesit Teknikë të Përfshirë në Licencën e Shoqërisë, si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:**

- 1 (një) Drejtues Projekti Projektues (Ndërtim/Hidroteknik)
- 1 (një) Projektues Ndertimi Profili Konstruktor
- 1 (një) Projektues Gjeodet/Topograf
- 1 (një) Projektues Elektrik
- 1 (një) Projektues Gjeolog

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

***Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.



**Argumentimi:** Operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin e suksesshëm të kontratës bazuar në neni 77, pika 4, të Ligjit 162/2020, “ Për prokurim publik” dhe neni 41, pika 4, gërma b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyren e Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Për realizimin e këtij studim projektimi objekti nevojitet nje ekip inxhinieresh te udhehequr nga **Drejtuesi i Projektit** qe ka detyra kryesore te lidhura me kryesisht me drejtimin dhe kordinimin e ekipit te inxhinierve te stafit, drjetimin e aktiviteve kryesore per realizimin e sherbimeve, prodhimin e dokumentave kryesore si dhe raporteve qe kerkohen sipas termave te references si dhe mbajtjen e kontakteve me autoritetin kontraktor. Profili i ketij pozicioni kerkohet te jete **Projektues Inxhinier Hidroteknik ose Ndertimi** pasi keto profile i pershtaten sherbimeve te kerkuara per projektimin e sistemeve te ujesjelles-kanalizimeve.

**Projektues Inxhinier Ndertimi Profili Konstruktor**, kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht projektimin e strukturave beton-arme me/pa prani të ujit, te lidhura me ngarkesën në tubacione, puseta apo dhoma kontrolli, kalimet e rrugëve kryesore dhe rrjeteve inxhinierike nëse do nevojitet. Gjithashtu nevojitet per kryerjen e llogaritjeve inxhinierike per percaktimin e shtresave rrugore si dhe materialit qe do te perdoret per mbushjen e kanaleve ku do te shtrohen linjat e kanalizimeve me qellim sigurimin e aftesise mbajttese dhe perballimin e ngarkesave te trafikut.

**Projektues Gjeodet/Topograf**, kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me azhornimin e rruges dhe te gjithe hapesires ku mendohet te kaloje sistemi i Kanalizimit, te jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak ne terren per saktesine e te dhenave, perpara fillimit te projektit te zbatimi, si dhe hartimin e planeve profileve terthorë dhe gjatësore topografike me kuota dhe hartave GIS.

**Projektues Elektrik**, kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me projektimin për impiantet elektrike, mekanike, stacionet e pompimit, makinerive, paisjeve por jo vetëm të kufizuar në to; përgatitjen e preventivit dhe analizat e koston për pajisje elektro-mekanike, hartimin e relacionit teknik për elektro-mekanike dhe specifikimeve teknike elektro-mekanike.

**Projektues Gjeolog** kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me studimet gjeologjike te trojeve dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet, hartimin e relacionit gjeologjik, hartimin preventivit dhe analizat e çmimeve dhe projektimit 77=përpara fillimit te projektit te zbatimit.

**2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të ketë Staf Ndhmës si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV, librezë pune dhe të listuar**

**në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:**

- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

***Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyren e Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

***Inxhinieri Hidroteknik*** kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me llogaritjet hidraulike per dimensionimin e tubacioneve te rrjetit te kanalizimeve bazuar ne modelimin e sistemit si dhe llogaritjet sipas kushteve teknike te projektimit.

***Inxhinier Ndertimit,*** kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht projektimin e strukturave beton-arme me/pa prani të ujit, me llogaritjet inxhinierike te lidhura me ngarkesën në tubacione, puseta apo dhoma kontrolli, kalimet e rrugëve kryesore dhe hekurudhat nëse do nevojitet. Gjithashtu nevojitet per kryerjen e llogaritjeve inxhinierike per percaktimin e shtresave rrugore si dhe materialit qe do te perdoret per mbushjen e kanaleve ku do te shtrohen linjat e kanalizimeve me qellim sigurimin e aftesise mbajttese dhe perballimin e ngarkesave te trafikut.

***Gjeodet/Topograf,*** kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me azhornimin e rruges dhe te gjithë hapësirës ku mendohet te kaloje sistemi i Kanalizimit, te jepet plani i piketimit

dhe verifikimi paraprak ne terren per saktesine e te dhenave, perpara fillimit te projektit te zbatimi, si dhe hartimin e planeve profileve terthore dhe gjatesore topografike me kuota dhe hartave GIS.

**Inxhinieri Mjedisit** kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me pergatitjen e raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis sipas legjislacionit mjedisor ne fuqi.

### **2.3.5 Një punësim mesatar i të paktën 10 (dhjetë) personave, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës e vërtetuar me:**

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
2. Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Përcaktimi i fuqisë punëtore minimale të kërkuar është bazuar në shpërbimet e kërkuara sipas Detyren e Projeçimit objekt prokurimi.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Gjithashtu duke ju referuar intensitetit të shërbimeve nevojitet operator ekonomik me staff të organizuar dhe të qëndrueshem për të garantuar shërbimet.

### **2.3.6 Operatori ekonomik duhet të kenë në Stafin e Shoqërisë Personel të kualifikuar/certifikuar si:**

- a) 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Diplome/certificate.

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi: Ekspert mjedisor për hartimin e VNM** është i nevojshëm për hartimin e raportit të Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) sipas përcaktimeve të Detyren e Projektimit.

Ky kriter është vendosur gjithashtu në përputhje me Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar në pikën 18 të nenit 6 të të cilit është është parashikuar se:

*“Ekspert i certifikuar i VNM-së” është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor dhe pikën 3 të nenit 6 të këtij ligji është parashikuar se:*

*“Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)” është procesi që kryhet për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private nëpërmjet:*

*a) përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga zhvilluesi;*

*b) kryerjes së konsultimeve sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji;*

*c) shqyrtimit nga autoriteti kompetent të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të çdo informacioni tjetër shtesë nga zhvilluesi, kur është i nevojshëm, si dhe të çdo informacioni tjetër të rëndësishëm, marrë nëpërmjet procesit të konsultimeve;*

*ç) përfundimit të arritur, të arsyetuar nga autoriteti kompetent, për ndikimet e rëndësishme në mjedis të projektit, duke marrë në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga autoriteti kompetent dhe kur është e përshtatshme shqyrtimin e vet shtesë;*

*d) përfshirjes në vendimin e miratimit të zhvillimit të projektit nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të përfundimeve të arritura të arsyetuara nga autoriteti kompetent.”*

### **2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat sipas Standarteve ISO, të vlefshme (ose ekuivalente), si me poshtë:**

- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente: Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë.

*(Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standardt që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre përpërbushjen e plotë të kontratës.

Certifikata ISO përshkruajnë tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar të këtij shërbimi dhe që i vlerëson këtë shërbim si të pranueshem për funksionin e kërkuar, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Certifikatat e cilësisë janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

### **2.3.8 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera Pajisjet Gjeodezike si më poshtë:**

- *1 (një) Pajisje GPS*
  - *Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.*
- *1 (një) Pajisje Total Station*
  - *Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.*
- *1 (një) Automjet*
  - *Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit/certifikate pronësie, siguracionin e mjetit, certifikatën e kontrollit teknik dhe lejen e qarkullimit. Për mjetet e siguruara me qera, dokumentet e mësipërme duhet të shoqërohen dhe me kontratën përkatëse noteriale të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës të objekt prokurimi.*

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

*Pajisje GPS se bashku me Pajisje Total Station kerkohen per te kryer matjet topografike dhe rilevimet qe lidhen me pozicionimin e rrjetit te kanalizimeve duke perfshire pusetat e kontrollit dhe lidhjet e konsumatoreve si dhe per ndertimin e ITUN se bashku me kolektorin e shkarkimit ne brendesi te mjedisit prites uhor.*

*Pajisje per matjet batrimetike single dhe multi-beam se bashku me motobarkën per realizimin e këtyre matjeve, kerkohet per te percaktuar pozicionimin e kolektorit te shkarkimit te ujerave te trajtuara nga impianti ne det. Pozicionimi lidhet sjelljen e rrymave detare ne menyre qe shkarkimet e ujerave te trajtuara mos ndikojne ne cilesine e ujerave lares ne breg por ndikimi i tyre te jete ne distance dhe thellesi te mjedisit uhor prites, det.*

### **2.3.9 Operatori ekonomik duhet paraqesë CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.**

**Argumentim:** Me ane te permbushjes se ketij kriteri Operatori ekonomik ben nje pasqyrim te te gjithë veprimtrise dhe punes se tij, e cila e ben me te besueshme ne permbushjen e sherbimit qe do te realizohet.

Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” i azhornuar.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*